



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
DREJTORIA JURIDIKE  
SEKTORI I MENAXHIMIT TË ASETIVE

**PROJEKT-VENDIM**

Nr. 12776 datë 06.11 2019

“ Për

**miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme që kërkohet të transferohet në pronësi të Njësisë Administrative Zejmen, Bashkia Lezhë , nga faza e inventarëve në fazën paraprake duke u bazuar në VKM-në nr.8.datë 07.01.2009 ”**

Mbështetur në ligjin numër 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9 pika 1.2 germa a, të ligjit numër 8743 datë 22.02.2001 “Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit” neni 8 i ndryshuar, të VKM numër 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore” si dhe në Udhëzimin numër 3 datë 18.07.2002 të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit “Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme të Shtetit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore”, duke qenë se ky proces është i papërfunduar:

**PROPOZOJ:**

4. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohet të transferohen në pronësi apo përdorim të Njësisë Administrative Zejmen - Bashkia Lezhë.
  - a. Lista e inventarit fillon me numrin 1 (një) dhe mbaron me numrin 79 (shtatëdhjetë e nëntë )
5. Paraqitjen e listës paraprake për miratim në Këshillin e Ministrave.
6. Ngarkohet Sektori i Menaxhimit të Aseteve dhe Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI**

**Pjerin NDREU**

